

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTAVE

Sot më datë 01 / 08 /2025, në Tiranë, midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. Z. Tarion Balla, atësia Naim, amësia Afërdita, shtetas shqiptar, lindur më 08.05.1978, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H80508151E dhe me pasaportë nr. BJ4515577, banues në Tiranë me adresë Rr. e Kavajës, Nd.99; H. 4; Ap. 3, Njësia Administrative nr.10, me miratimin e bashkëshortes së tij znj. Roven Balla, shtetase shqiptare, lindur më 05.01.1979, në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H95105049Q dhe me pasaportë nr. BG8792234, (këtu e në vijim referuar si “**Shitësi 1**”);
2. Z. Erin Çatri, atësia Kadri, amësia Marjana, shtetas shqiptar, lindur më 07.10.1982, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. 035097771 dhe nr. personal I21007164M, me miratimin e bashkëshortes së tij znj. Entela Postoli, shtetase shqiptare, lindur më 20.03.1972, në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H25320326B dhe me pasaportë nr. BE5703501, (këtu e në vijim referohet si “**Shitësi 2**”).

(Së bashku referuar si “**Shitësit**”).

Nga ana tjetër:

3. TEKNO FIRE SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L01307010S, me seli në Autostrada Tirane-Elbasan, KM 2, ndodhur ne Zkad 366, Ndertese me dy kate; kati I-re, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori Gramoz Çejku, shtetas shqiptar, lindur më 20.04.1988, në Lusën, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I80420143C dhe me pasaportë nr. BA9863003 (në vijim referuar si “**Blerësi**”).

DUKE QENË SE:

- A. Shitësit janë pronarë të kuotave që përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar (“**Kuotat e Shitura**”) të Shoqërisë “GET Solar Solution” SHPK, me numër (NUIS) M31603021D (“**Shoqëria**”), me përkatësisht Shitësin 1 pronar të një kuote që përfaqëson 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar dhe Shitësin 2 pronar të një kuote që përfaqëson 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar.
- B. Shitësit dëshirojnë t’i shesin Kuotat e Shitura Blerësit dhe Blerësi dëshiron të blejë Kuotat e Shitura sipas kushteve të mëposhtme.

ATËHERË: Lidhet kjo Kontratë Shitje (“**Kontrata**”) midis palëve me përmbajtje si më poshtë vijon:



1. OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1** Objekt i kësaj kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotave të Shitura në pronësi të Shitësve në Shoqërinë “GET Solar Solution ” SHPK, të cilat në total përfaqësojnë 100% (njëqind për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë (“**Kuotat e Shitura**”).
- 1.2** Pronësia e Kuotave të Shitura i kalon Blerësit në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate, dhe Kuotat e Shitura do të përfitohen së bashku me detyrimet dhe të drejtat e lidhura me to.

2. PRONËSIA E KUOTAVE TË SHITURA

- 2.1** Kuotat e Shitura transferohen dhe kalojnë në pronësi të Blerësit me transferimin e çmimit të shitjes në llogaritë bankare përkatëse të Shitësave dhe të nënshkrimit të Memorandumit të Përfundimit, sipas përmbajtjes në Aneksin 1 të kësaj Kontrate, në përputhje me kushtet dhe afatet të përcaktuara në Nenin 3.
- 2.2** Për të shmangur çdo paqartësi, Blerësi do të konsiderohet si ortaku i vetëm i Shoqërisë në momentin e nënshkrimit të Memorandumit të Përfundimit. Nëse Palët nuk nënshkruajnë Memorandumin e Përfundimit brenda afatit të përcaktuar në Nenin 3, detyrimi për kalimin e pronësisë mbi Kuotat e Shitura përfundon.

3. SHPËRBLIMI

- 3.1** Shitja e Kuotave të Shitura sipas kësaj Kontrate bëhet në favor të Blerësit kundrejt një çmimi total në vlerën 625.000 (gjashtëqind e njëzet e pese mijë) Euro, e ndarë në 437.000 (katërqind e tridhjetë e shtate mijë) Euro për kuotën e Shitësit 1, që përfaqëson 70% (shtatëdhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar, dhe 187.500 (njëqind e tetëdhjetë e shtate mijë) Euro për kuotën e Shitësit 2, që përfaqëson 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar.
- 3.2** Çmimi, sipas paragrafit të mësipërm, do të paguhet i plotë, pas zbritjes së të gjitha tatimeve në burim, dhe duhet të ketë kaluar në llogaritë bankare përkatëse të Shitësave që janë komunikuar Blerësit, brenda të njëjtës ditë me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

4. REGJISTRIMI I TRANSFERIMIT

- 4.1** Pas nënshkrimit të Memorandumit të Përfundimit, Shitësi do të njoftojë/regjistrojë këtë Kontratë dhe Vendimin për Shitjen e Kuotave dhe Ndryshimin e Administratorit sipas nenit 5.2, në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

5. DEKLARIMET, DETYRIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

- 5.1.** Shitësit deklarojnë, angazhohen dhe garantojnë Blerësit, se të gjitha deklaratimet, detyrimet dhe garancitë në vijim në vijim janë të vërteta dhe të sakta në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:
- (a)** Shitësit kanë të gjithë të drejtat dhe zotësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
- (b)** Pronësia e Kuotave të Shitura:
- Shitësit janë respektivisht pronarë ligjorë të Kuotave të Shitura të cilat janë regjistruar rregullisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - Kuotat e Shitura dhe të gjitha të drejtat e lidhura me to janë të lira nga çdo lloj pengu apo barre të çfarëdo natyre qoftë.



- (c) Shitësi siguron që Shoqëria është ekzistuese dhe e vlefshme, e organizuar rregullisht dhe e themeluar sipas ligjeve të Shqipërisë.
- (ç) Shoqëria ka bere deklarimin ne lidhje me pronarin përfitues fundor ne përputhje me kërkesat ligjore dhe nuk është dhe nuk do jete subjekt penaliteti ndaj organeve shtetërore ne lidhje me këtë deklarim.
- 5.2 Shitësit deklarojnë se kanë kryer të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin e Asamblesë së Pergjithshme të Shoqërisë për miratimin e vendimeve të mëposhtme ("**Vendimi për Shitjen e Kuotave dhe Ndryshimin e Administratorit**"):
 - a) Kalimi i pronësisë mbi kuotat te Blerësi.
 - b) Shkarkimin e administratorit Tarion Balla dhe emërimin e si administrator përfaqësuesin e caktuar nga Blerësi dhe që i është njoftuar Shitësave përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate.

6. DEKLARIMET, DETYRIMET DHE GARANCITË E BLERËSIT


- 6.1. Blerësi, deklaron, angazhohet dhe garanton Shitësat, se të gjitha deklaratimet, detyrimet dhe garancitë në vijim janë të vërteta dhe të sakta në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate:
 - (a) Blerësi ka të gjitha të drejtat dhe ka marrë të gjitha autorizimet e brendshme të nevojshme për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, duke përfshirë vendimin e asamblesë së përgjithshme të Blerësit për miratimin e lidhjes dhe nënshkrimit kësaj Kontrate për Shitjen e Kuotave.
 - (b) Blerësi pranon që të drejtat dhe detyrimet e tij në lidhje me Kuotat e Shitura dhe në përgjithësi me pjesëmarrjen e tij në kapitalin e Shoqërisë, janë kryer në përmbushje të interesit më të lartë të shoqërisë dhe ortakëve të saj sipas statutit dhe akteve ligjore në fuqi.
 - (c) Blerësi deklaron, pranon dhe angazhohet që ka ndërmarrë ose do të ndërmarrë, sipas rastit, të gjitha veprimet e ligjshme dhe të nevojshme për njoftimin, autorizimin dhe/ose regjistrimin e kësaj Kontrate dhe të çdo dokumenti tjetër të nevojshëm në regjistrin e pronarëve përfitues pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe në çdo autoritet tjetër të nevojshëm si autoritetet tatimore, autoriteti i konkurrencës etj.
 - (ç) Në rast se Blerësi nuk përmbush detyrimet e tij në këtë Kontratë dhe/ose shkel deklaratimet dhe garancitë e dhëna në këtë nen, atëherë Shitësi ka të drejtë të kërkojë çdo humbje apo dëmshpërblim tjetër si pasojë e mospërmbushjeve apo shkeljeve të Blerësit.
 - (d) Blerësi deklaron se ka kryer të gjitha vlerësimet dhe verifikimet e nevojshme (ligjore, financiare, tatimore, fizike etj.) në lidhje me transaksionin dhe pranon të blejë Kuotat e Shitura dhe Shoqërinë në gjendjen në të cilën ndodhet dhe se nuk ka më asnjë pretendim kundrejt Shitësave.

7. KOSTOT

- 7.1 Secila Palë duhet të mbajë përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe kryerjen e veprimeve ose nënshkrimin e dokumenteve të kërkuara sipas Kontratës.
- 7.2 Çdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar, nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i transferimit të Kuotave të Shitura, është në ngarkim të Shitësve, me përjashtim të komisioneve bankare të lidhura me transferimin e çmimit të cilat janë në ngarkim të Blerësit.

8. LIGJI I ZBATUESHEM

- 8.1 Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.



9. JURIDIKSIONI

- 9.1 Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përsa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë së saj do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

10. TË NDRYSHME DHE SHITESA

- 10.1 Asnjë ndryshim, shtesë, ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të Palëve.
- 10.2 Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e Palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontratës ose të Kontratës në tërësi, e cila do të interpretohet dhe do të zbatohet në mënyrë të pavarur.
- 10.3 Secila nga Palët angazhohet dhe garanton që ortakët ose përfaqësuesit e saj dhe çdo palë e tretë e lidhur me të, të ndërmarrin, pa vonesë, të gjitha veprimet dhe të kryejnë (ose të bëjnë që të kryhen) të gjitha veprimet e nevojshme dhe të nënshkruajnë e të dorëzojnë të gjitha dokumentet dhe deklaratat që mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme për të përmbushur plotësisht këtë Kontratë dhe transaksionet e parashikuara prej saj, si dhe për të mundësuar që çdo Palë të ushtrojë plotësisht të drejtat e saj dhe të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate.

11. ANEKSE

- 11.1 Çdo Aneks, shtesë apo ndryshim i kësaj Kontrate përbën pjesë integrale dhe të pandashme të saj dhe ka të njëjtën vlerë ligjore.
- 11.2 Kësaj Kontrate Shitje i bashkëngjitet Aneksi 1 që përmban “Memorandumin e Përfundimit”, i cili nënshkruhet nga Palët pasi të jetë verifikuar prej tyre përmbushja e të gjithë detyrimeve që i paraprijnë momentit të kalimit të pronësisë mbi Kuotat e Shitura.

12. GJUHA, KOPJET E KONTRATËS DHE HYRJA NË FUQI

- 12.1 Kjo Kontratë hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, një për secilin Shitës, një për Blerësin dhe një për Shoqërinë.

Shitësi 1

Z. Tarion Balla



Shitësi 2


Z. Erin Çatri



Blerësi

TEKNO FIRE SHPK


Përfaqësuar nga Gramoz Çejku



Bashkëshortja e z. Tarion Balla jep miratimin për nënshkrimin e kësaj Kontrate.

Znj. Roven Balla Rovena Balla


Bashkëshortja e z. Erin Çatri jep miratimin për nënshkrimin e kësaj Kontrate.

Znj. Entela Postoli Entela Postoli




ANEKSI 1
MEMORANDUMI I PËRFUNDIMIT

Sot më datë ____/____/2025 , në Tiranë, midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. Z. Tarion Balla, atësia Naim, amësia Afërdita, shtetas shqiptar, lindur më 08.05.1978, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H80508151E dhe me pasaportë nr. BJ4515577, banues në Tiranë me adresë Rr. e Kavajës, Nd.99; H. 4; Ap. 3, Njësia Administrative nr.10, me miratimin e bashkëshortes së tij znj. Roven Balla, shtetase shqiptare, lindur më 05.01.1979, në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H95105049Q dhe me pasaportë nr. BG8792234, (këtu e në vijim referuar si “**Shitësi 1**”);
2. Z. Erin Çatri, atësia Kadri, amësia Marjana, shtetas shqiptar, lindur më 07.10.1982, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. 035097771 dhe nr. personal I21007164M, me miratimin e bashkëshortes së tij znj. Entela Postoli, shtetase shqiptare, lindur më 20.03.1972, në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H25320326B dhe me pasaportë nr. BE5703501, (këtu e në vijim referohet si “**Shitësi 2**”).

(Së bashku referuar si “**Shitësit**”)

Nga ana tjetër:

3. TEKNO FIRE SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L01307010S, me seli në Autostrada Tirane-Elbasan, KM 2, ndodhur ne Zkad 366, Ndertese me dy kate; kati I-re, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori Gramoz Çejku, shtetas shqiptar, lindur më 20.04.1988, në Lusen, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I80420143C dhe me pasaportë nr. BA9863003 (në vijim referuar si “**Blerësi**”).

DUKE QENË SE:

- A. Palët kanë lidhur Kontratën e Shitjes së Kuotave datë ____/____/2025
- B. Sipas Kontratës shitja e Kuotave të Shitura dhe kalimi i pronësisë mbi to bëhen efektive vetëm me nënshkrimin e këtij Memorandumi Përfundimi.
- C. Palët dakordësohen se kanë përmbushur të gjithë detyrimet që i paraprijnë nënshkrimit të Memorandumit të Përfundimit.

ATËHERË: Lidhet ky Memorandum Përfundimi me përmbajtje si më poshtë vijon:

NENI 1

Të gjithë termat e përdorur në këtë Memorandum kanë të njëjtin kuptim me atë që i jepet në Kontratën për Shitjen e Kuotave.



NENI 2

Shitësit konfirmojnë pagesën e plotë nga ana e Blerësit të çmimit për shitjen e Kuotave të Shitura, sipas përcaktimit të Nenit 3 të Kontratës. Vlera totale e çmimit i është transferuar Shitësve sipas parashikimeve të të njëjtit nen.

NENI 3

Nga momenti i nënshkrimit të këtij Memorandumi, Palët bien dakord se kalimi i pronësisë mbi Kuotat e Shitura konsiderohet i kryer dhe Blerësi do të konsiderohet si ortak i vetëm i Shoqërisë "GET Solar Solution" SHPK dhe do të ushtrojë të gjitha të drejtat e do të mbajë përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo cilësi.

NENI 4

Ky Memorandum Përfundimi hyn në fuqi menjëherë.

Ky Memorandum Përfundimi hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, një për secilin Shitës, një për Blerësin dhe një për Shoqërinë.

Dispozitat e këtij Memorandumi janë të detyrueshme për Palët dhe përbëjnë pjesë integrale të Kontratës.

Shitësi 1

Z. Tarion Balla

Shitësi 2

Z. Erin Çatri

Blerësi

TEKNO FIRE SHPK

Përfaqësuar nga Gramoz Çejku

Bashkëshortja e z. Tarion Balla jep miratimin për nënshkrimin e këtij Memorandumi.

Znj. Roven Balla _____

Bashkëshortja e z. Erin Çatri jep miratimin për nënshkrimin e këtij Memorandumi.

Znj. Entela Postoli _____



MEMORANDUMI I PËRFUNDIMIT

Sot më datë 12/08/2025, në Tiranë, midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. Z. Tarion Balla, atësia Naim, amësia Afërdita, shtetas shqiptar, lindur më 08.05.1978, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H80508151E dhe me pasaportë nr. BJ4515577, banues në Tiranë me adresë Rr. e Kavajës, Nd.99; H. 4; Ap. 3, Njësia Administrative nr.10, me miratimin e bashkëshortes së tij znj. Roven Balla, shtetase shqiptare, lindur më 05.01.1979, në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H95105049Q dhe me pasaportë nr. BG8792234, (këtu e në vijim referuar si “**Shitësi 1**”);
2. Z. Erin Çatri, atësia Kadri, amësia Marjana, shtetas shqiptar, lindur më 07.10.1982, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. 035097771 dhe nr. personal I21007164M, me miratimin e bashkëshortes së tij znj. Entela Postoli, shtetase shqiptare, lindur më 20.03.1972, në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H25320326B dhe me pasaportë nr. BE5703501, (këtu e në vijim referohet si “**Shitësi 2**”).

(Së bashku referuar si “**Shitësit**”)

Nga ana tjetër:

3. TEKNO FIRE SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L01307010S, me seli në Autostrada Tirane-Elbasan, KM 2, ndodhur në Zkad 366, Ndertese me dy kate; kati I-re, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori Gramoz Çejku, shtetas shqiptar, lindur më 20.04.1988, në Lusën, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I80420143C dhe me pasaportë nr. BA9863003 (në vijim referuar si “**Blerësi**”).

DUKE QENË SE:

- A. Palët kanë lidhur Kontratën e Shitjes së Kuotave datë 08/08/2025
- B. Sipas Kontratës shitja e Kuotave të Shitura dhe kalimi i pronësisë mbi to bëhen efektive vetëm me nënshkrimin e këtij Memorandumi Përfundimi.
- C. Palët dakordësohen se kanë përmbushur të gjithë detyrimet që i paraprijnë nënshkrimit të Memorandumit të Përfundimit.

ATËHERË: Lidhet ky Memorandum Përfundimi me përmbajtje si më poshtë vijon:

NENI 1

Të gjithë termat e përdorur në këtë Memorandum kanë të njëjtin kuptim me atë që i jepet në Kontratën për Shitjen e Kuotave.

NENI 2

Shitësit konfirmojnë pagesën e plotë nga ana e Blerësit të çmimit për shitjen e Kuotave të Shitura, sipas përcaktimit të Nenit 3 të Kontratës. Vlera totale e çmimit i është transferuar Shitësve sipas parashikimeve të të njëjtit nen.

NENI 3

Nga momenti i nënshkrimit të këtij Memorandumi, Palët bien dakord se kalimi i pronësisë mbi Kuotat e Shitura konsiderohet i kryer dhe Blerësi do të konsiderohet si ortak i vetëm i Shoqërisë "GET Solar Solution" SHPK dhe do të ushtrojë të gjitha të drejtat e do të mbajë përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo cilësi.

NENI 4

Ky Memorandum Përfundimi hyn në fuqi menjëherë.

Ky Memorandum Përfundimi hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, një për secilin Shitës, një për Blerësin dhe një për Shoqërinë.

Dispozitat e këtij Memorandumi janë të detyrueshme për Palët dhe përbëjnë pjesë integrale të Kontratës.

Shitësi 1

Z. Tarion Balla



Shitësi 2


Z. Erin Çatri



Blerësi


TEKNO FIRE SHPK

Përfaqësuar nga Gramoz Çejku




Bashkëshortja e z. Tarion Balla jep miratimin për nënshkrimin e këtij Memorandumi.

Znj. Roven Balla



Bashkëshortja e z. Erin Çatri jep miratimin për nënshkrimin e këtij Memorandumi.

Znj. Entela Postoli



Banka
Bank Raiffeisen Bank

Dega
Branch 028

Date
Data 08/12/2025

☐ **Brenda Bankes**
Within Bank ☒ **Brenda Vendit**
National ☐ **Jashte Vendit**
International

☒ **Normale**
Normal ☐ **Urgjente**
Urgent

IBAN (Klienti Urdherues)
IBAN (Ordering customer) AL50202110060000000030743718

Klienti Urdherues
Ordering customer TEKNO FIRE SHPK L01307010S

Adresa (Klienti Urdherues)
Address (Ordering customer) AUT TR ELB,KM2,ZDK 366,ND2K,K1

Shuma (Shifra/Fjale)
Amounts (Figures/Words) 187,500.00

Monedha
Currency EUR

Kursi kembimit
Exchange Rate 1.0000000
0

NJE QIND E TETEDHJETE E SHTATE MIJE PESE QIND

Komisionet Bankare
Commission Charges ☐ SHA

☒ OUR

☐ BEN

Kodi SWIFT
SWIFT Code FINVALTR

Date Valuta
Value Date 08/12/2025

Te Dhenat e Bankes Perfituese,
Informacion shtese (Emri i
bankes,

Banka ndermjetese etj,)

Beneficiary Bank : Data Additional
information.(Bank name,
Intermediary bank etc.)

First Investment Bank Albania Sha IntermediaryBank :

Nr. LLog/IBAN (Klienti Perfitues)
No. Acc/IBAN (Beneficiary customer) AL8421511017EUR1000007081200

Klienti Perfitues
Beneficiary Customer ERIN CATRI

Adresa (Klienti Perfitues)
Address (Beneficiary Customer) TIRANE ALBANIA

Shteti
Country

Qellimi I Pageses
Remittance Information KALIM SIPAS KONTRATES PER SHITJEN 30 PERQIND TE KUOTAVE TE GET SOLAR
SOLUTION SHPK DT 01.08.2025

Kodi i Pageses
Payment Code DOMESTIC

Informacion Shtese
Additinal Information

Deklaroj se kam lexuar dhe jam darkord me deklaratat ne faqen e pasme te ketij formulari.
I Declare that i have read and i agree with the declarations in the backside of this form.

Emer Mbiemer i Klientit urdherues/Name Surname Ordering
Customer
Vula Kompanise/Stamp of The Company

Nenshkrimi i punonjesit bankes/Signature of the bank
employee
Vula Bankes/Stamp of The Bank

Banka nuk mban përgjegjësi për vonesa, mos ekzekutim të transfertave, kthim mbrapsht të transfertes, apo pasoja të tjera të shkaktuara nga pasaktesi në instruksionin e klientit.

Në qoftë se monedha e transfertës nuk përfshihet në listën e Bankave Korrespondente, Banka nuk mban përgjegjësi për ndryshimet në shumën e instruktuar për shkak të aplikimit të kushteve të ndryshme të konvertimit nga Bankat Korrespondente.

Deklaroj(më) se :

Jam (jemi) njohur dhe kam (kemi) pranuar Kushtet e Punes së Bankes dhe aplikimin e komisioneve përkatëse sipas Kushteve në fuqi për kryerjen e transfertes sipas këtij instruksioni.

Informacioni i dhënë nga unë (ne) në këtë formular është i saktë dhe i vërtetë.

Bazuar në Ligjin Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar, fondet e transferuara në këtë urdher pagese burojnë nga aktivitete të ligjshme dhe nuk përbejnë veprim për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit.

Bazuar në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale", jap(im) pelqimin tim (tone), për përpunimin e të dhënave personale të mia (tona) nga Banka dhe sipas rastit, të transferimit ndërkombëtar të tyre.

Dokumentacioni i paraqitur për kryerjen e kësaj transferte nuk është përdorur më parë për transferta të tjera, dhe është në përputhje me rregulloren e Bankes së Shqipërisë "Për veprimtarinë Valutore" dhe kuadrin rregullator dhe legjislativ në fuqi.

The Bank is not responsible for delays, non-execution, return of funds, or any other consequence that may result from inaccurate instructions of the customer.

If this transfer currency is not included in SSIs, the bank does not bear any responsibility for any difference amount may occur due to different exchange rates applied from correspondent banks.

I(We) declare that :

I (we) have read and accepted the Bank's Terms & Conditions and I agree to the application by the Bank of relevant commissions for the execution of the transfer as per this instruction.

The information I (we) have given in this form is correct and true.

Based on the Law no. 9917, dated 19.05.2008 "On the prevention of money laundering and financing of terrorism", as amended, the funds transferred by this payment order have been obtained by legal activities and do not constitute action for money laundering or terrorism financing.

Based on Law no. 9887, dated 10.03.2008 "On Personal Data Protection", I(we) give my (our) consent for the processing of my (our) personal data by the Bank and, where appropriate, their international transfer.

The documentation submitted for performing this transfer has not been used previously for other transfers, and is in accordance with the regulation of Bank of Albania "On Foreign Exchange Activities" and the legal and regulatory framework in power.

Banka
Bank Raiffeisen Bank

Dega
Branch 028

Date
Data 08/12/2025

☐ **Brenda Bankes** ☒ **Brenda Vendit** ☐ **Jashte Vendit**
Within Bank National International

☒ **Normale** ☐ **Urgjente**
Normal Urgent

IBAN (Klienti Urdherues)
IBAN (Ordering customer) AL50202110060000000030743718

Klienti Urdherues
Ordering customer TEKNO FIRE SHPK L01307010S

Adresa (Klienti Urdherues)
Address (Ordering customer) AUT TR ELB,KM2,ZDK 366,ND2K,K1

Shuma (Shifra/Fjale)
Amounts (Figures/Words) 437,000.00

KATER QIND E TRIDHJETE E SHTATE MIJE

Monedha
Currency EUR
Kursi kembimit
Exchange Rate 1.0000000
0

Komisionet Bankare
Commission Charges ☐ SHA ☒ OUR ☐ BEN

Kodi SWIFT
SWIFT Code FINVALTR **Date Valuta**
Value Date 08/13/2025

Te Dhenat e Bankes Perfituese,
Informacion shtese (Emri i
bankes,

Banka ndermjetese etj,)
Beneficiary Bank : Data Additional First Investment Bank Albania Sha IntermediaryBank :
information.(Bank name,
Intermediary bank etc.)

Nr. LLog/IBAN (Klienti Perfitues)
No. Acc/IBAN (Beneficiary customer) AL1921511031EUR1000007067000

Klienti Perfitues
Beneficiary Customer TARION BALLA

Adresa (Klienti Perfitues)
Address (Beneficiary Customer) . TIRANE ALBANIA

Shteti
Country


Qellimi I Pageses
Remittance Information KALIM 70 PERQIND TE KUOTAVE TE SHITJES TE SHOQ GET SOLAR Solutin PRONARIT
TARION BALLA DT 01.08.2025

Kodi i Pageses
Payment Code DOMESTIC

Informacion Shtese
Additinal Information

Deklaroj se kam lexuar dhe jam darkord me deklaratat ne faqen e pasme te ketij formulari.
I Declare that i have read and i agree with the declarations in the backside of this form.


Emer Mbiemer i Klientit urdherues/Name Surname Ordering
Customer
Vula Kompanise/Stamp of The Company


Nenshkrimi i punonjesit bankes/Signature of the bank
employee
Vula Bankes/Stamp of The Bank

Banka nuk mban përgjegjësi për vonesa, mos ekzekutim të transfertave, kthim mbrapsht të transfertes, apo pasoja të tjera të shkaktuara nga pasaktësi në instruksionin e klientit.

Në qoftë se monedha e transfertës nuk përfshihet në listën e Bankave Korrespondente, Banka nuk mban përgjegjësi për ndryshimet në shumën e instruktuar për shkak të aplikimit të kushteve të ndryshme të konvertimit nga Bankat Korrespondente.

Deklaroj(më) se :
Jam (jemi) njohur dhe kam (kemi) pranuar Kushtet e Punes së Bankes dhe aplikimin e komisioneve përkatëse sipas Kushteve në fuqi për kryerjen e transfertes sipas këtij instruksioni.

Informacioni i dhënë nga unë (ne) në këtë formular është i saktë dhe i vërtetë.

Bazuar në Ligjin Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar, fondet e transferuara në këtë urdher pagesë burojnë nga aktivitete të ligjshme dhe nuk përbejnë veprim për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit.

Bazuar në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale", jap(im) pelqimin tim (tone), për përpunimin e të dhënave personale të mia (tona) nga Banka dhe sipas rastit, të transferimit ndërkombëtar të tyre.

Dokumentacioni i paraqitur për kryerjen e kësaj transferte nuk është përdorur më parë për transferta të tjera, dhe është në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për veprimtarinë Valutore" dhe kuadrin rregullator e legjislativ në fuqi.

The Bank is not responsible for delays, non-execution, return of funds, or any other consequence that may result from inaccurate instructions of the customer.

If this transfer currency is not included in SSIs, the bank does not bear any responsibility for any difference amount may occur due to different exchange rates applied from correspondent banks.

I(We) declare that :
I (we) have read and accepted the Bank's Terms & Conditions and I agree to the application by the Bank of relevant commissions for the execution of the transfer as per this instruction.

The information I (we) have given in this form is correct and true.

Based on the Law no. 9917, dated 19.05.2008 "On the prevention of money laundering and financing of terrorism", as amended, the funds transferred by this payment order have been obtained by legal activities and do not constitute action for money laundering or terrorism financing.

Based on Law no. 9887, dated 10.03.2008 "On Personal Data Protection", I(we) give my (our) consent for the processing of my (our) personal data by the Bank and, where appropriate, their international transfer.

The documentation submitted for performing this transfer has not been used previously for other transfers, and is in accordance with the regulation of Bank of Albania "On Foreign Exchange Activities" and the legal and regulatory framework in power.